



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 1373/2024

Datë: 27 dhjetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenit 22 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafit 9 si dhe nenit 24 paragrafit 3 të Rregullores Nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 27 dhjetor 2024, mori këtë:

**VENDIM**

1. Z. Petrit Kryeziu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, emërohet Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren.
2. Mandati i z. Kryeziu fillon nga data 27 dhjetor 2024 për periudhën katër (4) vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.
3. Z. Kryeziu, pas përfundimit të mandatit si Kryeprokuror, do të vazhdojë punën në pozitën e prokurorit në prokurorinë ku ka shërbyer si prokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren.
4. Obligohet z. Kryeziu që detyrat dhe përgjegjësitë t'i ushtrojë në bazë të legjislacionit në fuqi.
5. Z. Kryeziu ka të drejtë në shfrytëzimin e beneficioneve që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren.
6. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Petrit Kryeziu, prokuror në PTH Prizren;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.